



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.371/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e Emsale Selmani, për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 11.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si i pabazuar** apeli Anr.371/2019 i Emsale Selmani, paraqitur kundër KQZ për shkak të mos përfshirjes në listën e votuesve jashtë Kosovës.

### A r s y e t i m

Komisioni Qendror i Zgjedhje me datë:19.09.2019 ka miratuar listën përfundimtare për votuesit jashtë Kosovës.

Me datën 11.10.2019, ka pranuar një apel nëpërmjet postës të dorëzuar me datën 20.09.2019, parashtruesi i apelit, Emsale Selmani, ka parashtruar ankesë kundër vendimit të KQZ të datës:11.10.2019 kur është miratuar lista përfundimtare e votuesve, me pretendimin se i njëjti edhe pse kishte aplikuar me datë: 01.09.2019 për të hyrë në listë të votuesve jashtë Kosovës, më datë 19.09.2019 është njoftuar se nuk ka përmbushur kushtet që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës. E njëjta thekson se prindërit e saj janë përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosove , po ashtu pretendon se i plotëson kushtet që të përfshihet në këtë listë.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoj të gjitha pretendimit e apelit, në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën konstatoi se apeli është i pabazuar pasi që parashtruesi i apelit gjate aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës në momentin e aplikimit në KQZ, për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk ka ofruar dosjen e kompletuar dhe nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara siç parashihet me dispozitat e Rregullës Zgjedhore 03/2013 të KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par.3, 118 par.1, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.371/2019 më datën 11.10..2019.

**Kryesuese e Panelit  
Gyltene Sylejmani**



***Këshillë Juridike:***

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në *Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.*